



NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NËXTITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NËXTUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFLIJE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#114

TAKIMI/ Në Tiranë organizohet “Samiti i Grave të Biznesit”



Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare organizon “Samiti i Grave të Biznesit” më 8 korrik 2021.

Ky aktivitet do të organizohet në dy seanca: “Leadershipi i gruas në Biznes” dhe “Sfidat e Gruas Sipermarrëse të Diasporës në Situata Pandemie”.

Takim do të bëjë bashkë, gra sipërmarrëse të Diasporës shqiptare dhe të vendit tonë, profesioniste të reja, gra akademike dhe eksperte në fushën e biznesit, përfaqësues të institucioneve shtetërore, si dhe të organizatave ndërkombëtare, veçanërisht ato të cilat në programet e tyre kanë zhvilluar objektiva, lidhur me gratë dhe zhvillimin e tyre në fushën e biznesit dhe sipërmarrjes.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë online për rinovimin e dokumentave të tyre biometrike (pasaportë dhe ID) si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit

REVISTA LETRARE/ "Letra nga Diaspora" prezantohet në festivalin mbarëkombëtar "Passaggi"

Mbahet edicioni i nëntë të festivalit mbarëkombëtar “Passaggi”, një ngjarje kulturore ndërkombëtare kushtuar librit dhe analizave bashkëkohore letrare. Takimi Evropë/Mesdhe këtë vit, kushtuar autorëve të Ballkanit ka nisur me praninë e drejtoreshës së Qendrës së Botimeve për Diasporën znj. Mimoza Hysa, e cila prezantoi revistën letrare “Letra nga Diaspora”.

Ky botim letrar, me intervista, analiza, retrospektivë dhe krijimtari të autorëve në Diasporë vjen jo vetëm me synimin për të mbrojtur dhe përhapur gjuhën shqipe përmes letrave të bukura, por edhe për të vendosur ura komunikimi të autorëve shqiptarë në kohë apo vende të ndryshme, mes vetes dhe lexuesit, shqiptar apo të huaj, në mbështetje të krijimtarisë më të mirë. Revista “Letra nga Diaspora” dhe kartolinat e autorëve në Diasporë u promovuan përmes festivalit në të gjitha pikat e qytetit.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke formuar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale e ndryshme në Diasporë.

QBD / Botohen 18 tituj të rinj të serisë klasikët dygjuhësh



Qendrës së Botimeve për Diasporën ka nxjerrë nga botimi 18 tituj të rinj të serisë klasikët dygjuhësh. Një seri e cila aktualisht ofrohet e plotë edhe online, falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën.

Botimet dygjuhëshe janë tekste të cilat u vijnë në ndihmë të fëmijëve të Diasporës. Tituj e përrallave si “Sirena e vogël”, “Udhëtimet e Gulliverit”, “Piter Pani”, “Libri i xhunglës”, etj janë të përzgjedhur me kujdes, dhe të plotësuar me ilustrime të bukura e tërheqëse, me një shqipërim mjeshtror dhe të përshtatur për fëmijët e grupmoshës 5-8 vjeç.

Librat përveçse për fëmijët, këshillohen të përdoren edhe nga mësuesit e gjuhës shqipe në Diasporë, si një alternativë shtesë për ta bërë orën e mësimi më të pasur dhe më argëtuese, duke ndikuar në pasurimin e fjalorit dhe të shprehive në gjuhën shqipe të fëmijët dhe duke nxitur interesin e dashurinë për gjuhën shqipe.




Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

KUVENDI I QSPA/ Gjendja aktuale e studimeve mbi Arbëreshët

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), organizon Kuvendin e parë të saj me temën: “Gjendja aktuale e studimeve arbëreshe”.

Ky tubim mëton të nxjerrë në pah arritjet e deritanishme në lëmitë e ndryshme të studimeve mbi universin arbëresh si në studimet gjuhësore, studimet letrare, etnografike, antropologjike kulturore, të çështjeve juridike që lidhen me statusin aktual të arbërishtes si dhe, të përpunojë një strategji pune të përbashkët me të gjitha forcat studiuese në të gjitha trevat shqipfolëse, por po aq edhe të gjithë albanologëve të huaj që kanë patur e kanë në vëmendjen e tyre çështjen e Arbërisë. Njëkohësisht, ky Kuvend mëton të dalë me një Rezolutë mbi perspektivat e ardhshme të zhvillimit të të gjithë këtyre problematikave.

Kuvendi do të ketë të ftuar, kumtues me emër e reputacion të spikatur në mjedisin studimor të këtyre lëmive, nga brenda dhe jashtë Shqipërisë.



Digjitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

Dhuro Libra



Nisma “Dhuro libra” do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.